



VENDIM

Nr. 44 Datë 13.05.2014

MBI

ANKIMIN E CEZ SHPËRNDARJE SH.A NE ADMINISTRIM TE PËRKOHSHËM MBI VENDIMIN NR. 27 DATE 31.03.2014 "PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP MBI VERIFIKIMIN E MATËSAVE KUR FUTEN PËR HERE TE PARE NE TREG DHE/OSE KUR VENDOSEN PËR HERE TE PARE NE PËRDORIM; INSPEKTIMIN PERIODIK PËR VERIFIKIMIN E SAKTËSISË SE MATËSAVE DHE TE SISTEMIT TE MATJES SE ENERGJISË ELEKTRIKE, KOLAUDIMIN DHE VULOSJEN SI DHE TE MIRËMBAJTJES SE TYRE"

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar dhe nenit 16 pika 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.05.2014, mbasi shqyrtoi ankimimin e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a në lidhje me vendimin nr. 27, datë 31.03.2014 "Për miratimin e Kontratës Tip mbi verifikimin e matësve kur futen për here te pare ne treg dhe/ose kur vendosen për here te pare ne përdorim; inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë se matësve dhe te sistemit te matjes se energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen si dhe te mirëmbajtjes se tyre",

Konstatohet se:

- CEZ Shpërndarje është njoftuar për vendimin nr. 27, datë 31.03.2014, me ane te shkresës nr. 288/1 Prot., date 01.04.2014.
- Ankimi siç citohet edhe me sipër është dërguar ne ERE me shkresën nr. 3727/1 Prot., date 28.04.2014.
- Baza ligjore për paraqitjen e këtij ankimi i është referuar nenit 16 pika 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s në të cilin përcaktohet se:

"Për aktet me karakter normativ, çdo palë e përfshirë në proces mund te paraqes ne ERE një kërkesë për rishikim vendimi te Bordit te Komisionerëve brenda 5 dite pune nga data e marrjes se njoftimit te vendimi te Bordit. Kërkesa për rishikim vendimi do te shoqërohet detyrimisht me

provat e reja qe mendohet se mund te çojnë Bordin ne një vendimarrje te re. ERE do te trajtojë kërkesën për rishikim vendimi brenda 30 ditëve kalendarike duke ndjekur te njëjtin proces qe shërbeu për miratimin e vendimin. Kërkesa për rishikim vendimi nuk pezullon zbatimin e vendimit me përjashtim kur Bordi i Komisionerëve vendos ndryshe.”

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Mospranimin e ankimimit të CEZ Shpërndarje sh.a për vendimin nr. 27, datë 31.03.2014 “Për miratimin e kontratës Tip mbi verifikimin e matësave kur futen për here te pare ne treg dhe/ose kur vendosen për here te pare ne përdorim; inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë se matësave dhe te sistemit te matjes se energjisë elektrike, kolaudimin dhe vulosjen si dhe te mirëmbajtjes se tyre”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë ankimuese CEZ Shpërndarje sh.a, dhe DPM për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.